



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 677/3 Prot

Tiranë, më 07.09.2021

**V E N D I M**

Nr. 104, datë 07.09.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt “Mbi verifikimin e statusit të nëpunësit civil, \*\*\*\*\*, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të aktit nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz”, për emërimin e nëpunësit \*\*\*\*\*, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës, protokolluar me nr. 398 prot, datë 09.03.2021, paraqitur nga Bashkia Kamëz, është ngritur pretendimi se në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, \*\*\*\*\*, aktualisht mbajtës i pozicionit të punës, “Inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore” në Bashkinë Kamëz, emëruar në këtë detyrë me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, vazhdon të jetë i emëruar me kontratë me afat të caktuar, ndërkohë, që duhet të ishte pjesë e shërbimit civil, dhe si i tillë ky pozicion duhej të plotësohej vetëm nëpërmjet kryerjes së procedurës së konkurrimit, parashikuar nga nenet 21 deri 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III

“Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer verifikimi paraprak i informacionit të dërguar nga Bashkia Kamëz ku rezultoi se \*\*\*\*\* , ka filluar punë në Bashkinë Kamëz, me Urdhrin nr. 348, datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore”, ku pjesë e këtij urdhëri ishte edhe kontrata me afat të caktuar, nr. 3188 prot. datë 02.10.2015 (kjo thuhet edhe në përmbajtjen e urdhrit).

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i dosjes personale të punonjësit në fjalë, u konstatua se \*\*\*\*\* , ka filluar punë në Bashkinë Kamëz, me Urdhrin nr. 348 datë 2.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, në pozicionin “Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore”, ku pjesë e këtij urdhëri ishte edhe kontrata me afat të caktuar, nr. 3188 prot. datë 02.10.2015 (kjo thuhet edhe në përmbajtjen e urdhrit).

Gjatë takimit me përfaqësues nga Bashkia Kamëz, u shqyrtua përmbajtja e strukturës së Bashkisë Kamëz, të vitit 2015 (koha ku ka filluar punë punonjësi) si dhe përmbajtja e strukturës aktuale të kësaj bashkie, prej nga rezultoi se pozicioni i punës “Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore”, vazhdimisht ka qenë dhe është pjesë e shërbimit civil dhe si i tillë ky pozicion duhej të plotësohej vetëm nëpërmjet kryerjes së procedurës së konkurrimit, parashikuar nga nenet 21 deri 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në këto kushte, duke qenë se marrëdhënia aktuale e punësimit të nëpunësit \*\*\*\*\* , nuk është lidhur në respektim të kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, arrihet në përfundimin se ai nuk e ka fituar statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, ai nuk mund të përfitojë statusin e nëpunësit civil, nga mundësia që ka dhënë dispozita e nenit 67, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pasi marrëdhënia e tij e punësimit është lidhur pas datës 26.02.2014, (që ka qenë dita e fillimit të efekteve të ligjit në fjalë), e si e tillë nuk mund të trajtohet si marrëdhënie punësimi ekzistuese, në momentin e fillimit të veprimit të këtij ligji.

Përfundimisht, bazuar në përcaktimin e pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, sipas së cilës, çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është “absolutisht i pavlefshëm”, marrëdhënia e punësimit të punonjësit \*\*\*\*\* nuk është marrëdhënie në shërbimin civil dhe njësisë përgjegjëse të Bashkisë Kamëz, i lind e drejta dhe detyrimi, të urdhërojë menjëherë, ndërprerjen e kësaj marrëdhënie punësimi dhe të marrë masat për plotësimin e pozicionit nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”,

miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Për rregullimin e gjëndjes së ligjshmërisë, Njësia Përgjegjëse dhe Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Kamëz, të marrin masa të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për punonjës të \*\*\*\*\*, si dhe të shpallë menjëherë pozicionin të lirë, për plotësimin e tij sipas rregullave të legjislacionit të shërbimit civil.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 5 ditë, nga marrja dijeni e vendimit.
3. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Njësia Përgjegjëse dhe Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Kamëz.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**